



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

AC-I-23-0683-A0001

**Në çështjen juridike të:**

**A i o SHKP**, me seli në Fushë Kosovë, me pronar Xh P, të cilin e përfaqëson avokati B S nga Prishtina.

**Paditësi**

**Kundër:**

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)**, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishte- Prishtinë.

**E paditura/ankuesja**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër Aktvendimit të Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-I.-23-0031, të datës 01 nëntor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

1. Ankesa e të paditurës aprovet si e bazuar.
2. Anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-I.-23-0031, i datës 01 nëntor 2023.
3. Lënda kthehet për rigjykim dhe rivendoje në Kolegjin e njëjtë të Sjhkallës së parë të DHPGJSK-së.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 29 shtator 2023, paditësi kishte parashtruar padi me Kërkesë për caktimin e masës së sigurisë, në DHPGJSK, kundër Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së BD 185/1, të datës

21 gusht 2023 dhe Njoftimit të datës 28 gusht 2023 për përmbushje të kontratës së qirasë dhe aneks kontratës së qirasë të datë 5 qershor 2023. Parashtruesi kërkon mos ndryshimin e kushteve të qirasë që ishin përcaktuar me kontratën e qirasë dhe me aneks kontratën e datës 05 qershor 2023 deri në përfundimin e raporteve kontraktuale ndërmjet palëve ndërgjyqëse.

Paditësi pretendon se në bazë të kontratës së qirasë nga viti 2016, është në shfrytëzim të ngastrave nr..., ..dhe ..., të regjistruar në fletën poseduese nr..., me sipërfaqe prej 15.000 m2, pronë e NSH KBI "Staro Gracko", dhe se sipas kësaj kontrate ai paguan qiranë mujore në shumën 250.00 euro.

Sipas paditësit, ai kishte pranuar njoftimin nga kryesuesi i Autoritetit të Likudimit të NSH "Staro Gracko", me të cilin ishte njoftuar lidhur me Vendimin ref BD-185, datë 21 gusht 2023, për ndryshimin e lartësisë së qirasë. Sipas vendimit, aseti i cili është objekt i qirasë, duke filluar nga data 01 tetor 2023, do të jetë me çmim 1.075.00 euro.

Paditësi thekson se shuma e qirasë nga 250.00 euro, në shumën 1.705.00 euro është rritë 430%, dhe se ky ndryshim i çmimit të qirasë sipas aneks kontratës të datës 05 qershor 2023, ka për qëllim ta dëmtoj paditësin/propozuesin, ndërsa ekziston rreziku për dëm të riparueshëm.

Më 05 tetor 2023, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër propozimit për caktimin e masës së sigurisë së paditësit theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit duke i konsideruar të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. E paditura ka pohuar se paditësi kishte dështuar të paraqesë dëshmi për të argumentuar pretendimet e veta dhe prova që e bëjnë të besueshme kërkesën e tij. E paditura i referohet praktikës gjyqësore të Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së, me të cilin ishte hedhur poshtë propozimi i paditësit për lëshimin e masës së sigurimit dhe e kishte aprovuar ankesën e AKP-së, me Aktvendimin AC-I.-23-0253 të datës 25 maj 2023.

Më 01 nëntor 2023, Kolegji i Shkallës së parë të DHPGJSK-së kishte marrë Aktvendim me të cilin refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit e ushtruar nga propozuesi, ashtu që kundërshtarit të sigurimit AKP-së, i ndalohet ndryshimi i kushteve të kontratës për qira të datës 08 korrik 2016 dhe aneks kontratës të datës 05 qershor 2023, deri në përfundim të periudhës kontraktore. Sipas arsytimit të dhënë, pala e cila e pohon ekzistimin e një fakti, ajo është e obliguar të paraqes prova fizike dhe /ose dëshmuese për mbështetjen e atij pohimi. Paditësi nuk kishte paraqitur prova që e bëjnë të besueshme kërkesën e tij, pasi që i njëjti ishte pajtuar me aneks kontratën e datës 05 qershor 2013, nenin 2.2 për mundësinë e

ndryshimit të çmimit të kontratës, në rastin konkret edhe ndryshimi i çmimit të kontratës është çështje e vullnetit të palëve kontraktuese. Kjo klauzolë kontraktuese nuk ishte kundërshtuar nga asnjë palë deri në këtë fazë të procedurës. Sa i përket dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm të cilin konsideron paditësi, nuk është prezent me vetë faktin se paditësi e ka ditur rrethanën në ankes kontratë, se çmimi i qirasë pas nënshkrimit të aneks kontratës, atij do t'i ndryshohet. Kolegji i Shkallës së parë thekson se nuk është lëshuar në lidhje me vlerësimin e lartësisë së çmimit real të qirasë nga shuma 250.00 euro dhe rivlerësimin të çmimit në shumën prej 1.075.00 euro për shfrytëzimin e sipërfaqes së tokës 1.5000 m<sup>2</sup>, i cili është objekt i kontratës së qirasë. Mëqenëse paditësi nuk e kishte bërë të besueshme kërkesën e tij për dëmin e pa riparueshëm, propozimi për caktimin e masës së sigurimit, është refuzuar pasi nuk janë plotësuar kushtet sipas nenit 61 të Ligjit nr. 06/L086.

Më 08 nëntor 2023 AKP kishte parashtruar një parashtrësë për Korrigjimin e Aktvendimit C-I-23-0031 të datës 02 nëntor 2023 pasi që dispozitivi i këtij atvendimi është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin ligjor. Askush nuk ka dashur që të merret më me këtë parashtrësë duke e injoruar të njëjtën.

Më 14 nëntor 2023, e paditura/ankuesja kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktvendimi duke propozuar që të aprovohet ankesa, të anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Shkallës së parë, C-I-23-0031 i datës 01.11.2023. Ankuesja konsideron se aktvendimi i kontestuar përmban dispozitiv të pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetvete, ose me arsyet e aktvendimit dhe në arsyetimin e tij nuk janë parqitur arsye të plota dhe të kuptueshme për faktet vendimtare, kurse arsyet e paraqitura janë kundërthënëse me përmbajtjen e provave të shqyrtuara.

E paditura thekson se përkundër faktit se në dispozitiv të aktvendimit refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit, në të njëjtën kohë i ndalon kundërshtarit në këtë rast të paditurës, t'i ndryshojë kushtet e kontratës së qirasë dhe aneksin e kontratës së qirasë të datës 05 qershor 2023, deri në përfundim të periudhës kontraktuese..

Më 15 nëntor 2023, Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së përmes një urdhëri gjyqësor e ka dërguar tek paditësi këtë ankesë për përgjigje. Përfaqësuesi i paditësit e ka pranuar urdhërin më 20 nëntor 2023, por nuk ka dërguar asnjë përgjigje deri më tani.

Më 21 nëntor 2023, gjyqtari individual i rastit ka marrë Aktvendimin C-I.-23-0031 me të cilin është refuzuar kërkesa për korrigjimin e aktvendimit, me arsyetimin se nuk ka gabime teknike dhe se dispozitivi është i qartë.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të ligjit nr.06/L086 mbi Dhomën e Posqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për qështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Shkallës së parë e DHPGJSK-së me Aktvendimin e ankimuar e kishte refuzuar propozimin e paditësit për caktimin e masës së sigurimit, në anën tjetër i'a ka ndaluar AKP-së ndryshimin e kushteve të kontratës për qiranë të datës 08 korrik 2016 dhe aneks kontratës datë 05 qershor 2023, deri në përfundim të periudhës kontraktore. Në arsyetimin e këtij vendimi shihet qartë se kërkesa për masë të sigurimit ishte refuzuar.

AKP në ankesën e saj thekson se aktvendimi i ankimuar është kontreditor në dispozitiv dhe me arsyetimin ligjor dhe si l tillë duhet të anulohet.

Lidhur me këtë lëshim të Kolegjit të Shkallës së parë AKP kishte parashtruar kërkesë për korrigjim të këtij aktvendimi, por gjyqtari relator në shkallë të parë nuk ka dashur që të merret më me këtë kërkesë.

Pas vërejtjeve të shumta, më në fund gjyqtari i çështjes kishte marrë individualisht, jo në kolegji, një aktvendim me të cilin e ka refuzuar propozimin për korrigjim, me arsyetimin se nuk është bërë kurrfarë gabimi as në dispozitiv e as në arsyetim, andaj nuk ka bërë asnjë korrigjim.

Kolegji i Apelit pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore të të paditurës, aktvendimin e ankimuar dhe shkresat e lëndës dhe ka gjetur se ankesa është e bazuar.

Kolegji i Apelit konsideron se aktvendimi i ankimuar është kontradiktor në dispozitiv dhe në arsyetimin ligjor. Në dispozitiv në njërën anë refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurisë, derisa në të njëjtën pikë të dispozitivit, i ndalohet AKP-së ndryshimi i kushteve të kontratës. Ky është një kontraditoritet i qartë në dispozitiv të këtij aktvendimi, e që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, neni 182.2 (n) të LPK-së.

Në rastin konkret është refuzuar edhe ky propozim për korrigjimin e aktvendimit nga një gjyqtar i vetëm, edhe pse në këtë rast është dashur që të vendoset nga Kolegji që kishte marrë aktvendimin e ankimuar, për të cilin kërkohet korrigjimi. Edhe në këtë rast është vepruar në kundërshtim me nenin 182.2 (a) të LPK-së.

Për këto arsye si më lartë kjo ankesë nuk mund të gjykohet në meritat e saj, pasi që Shkalla e parë ka dështuar të kryej veprimet që janë të nevojshme në rast se kërkohet korrigjimi i një vendimi. Madje, edhe kur ka marrë një vendim, atë e ka bërë në kundërshtim me ligjin, andaj procedura duhet të kthehet në fazën fillestare të saj në mënyrë që të mos lihet asnjë dyshim lidhur me përmbushjen e procedurës së paraparë ligjore.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos sin ë dispozitiv të këtij aktvendimi.

### **Taksa gjyqësore**

AKP për ankesën e saj tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore para Kolegjit të Apelit, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së më 07 dhjetor 2023.

**Mr.sc Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues** \_\_\_\_\_